

VENDIM
Nr.69, datë 28.1.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË KRUMË TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Krumë të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Krumë të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr.587, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Krumës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Krumës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Krumë

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
4,5,17,18,19,21,24-28	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
35-48	Prona që përdoren në fushën e arsimit.	Në pronësi
49-54,256-289,294-302,303-324	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës.	Në pronësi
55,57,58,59,60-62	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë bujqësore).	Në përdorim
56,63,64/8,65/3,66/2	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë jobujqësore kanale të treta).	Në pronësi
67-184	Pyje dhe kullota (komunale).	Në pronësi
185-203	Shërbim funeral.	Në pronësi
204-222	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile dhe strehimit.	Në pronësi
248,252-255	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
325-339	Prona që përdoren në realizimin e programeve sportive dhe kulturore.	Në pronësi
362-363,364	Furnizimi me ujë të pijshëm.	Në pronësi
365	Prona që përdoren në fushën e ndriçimit	Në pronësi

	publik.	
340-358,364	Infrastrukturë vendore (rrugë, lulishte, trotuare sheshe).	Në pronësi